VENDIM
Nr. 667, datë 8.10.2014

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATËT E TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, 29, pika 1, dhe 67, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", dhe në vijim të pikave 2, 3 dhe 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht për vitin 2014, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) është e hapur edhe për kandidatët e tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2014, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 83 veta.

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë për kandidatët nga jashtë shërbimit civil janë, si më poshtë vijon:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "dh", të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013;

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master shkencor" ose të barasvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione drejtuese ose të barasvlefshme me to, në:

- institucione të administratës publike;
- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij.

Përjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë në institucione ndërkombëtare brenda vendit, në profesion jashtë vendit ose në profesione të rregulluara brenda ose jashtë vendit, duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vite pune përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

ç) Të mos jenë larguar nga puna si rezultat i shkeljeve të rënda apo të lehta, por të përsëritura;

d) Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Departamenti i

Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama